

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit H. E. nga fshati ..... Komuna e Prizreni, për shkak të veprave penale ndotja degradimi dhe shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamentit të Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.58/2014 të datës 18.03.2015, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Mehreme Hoxha dhe të akuzuarit, me datë 07.12.2015 publikisht morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### **I akuzuari:**

**H. E.** nga i ati R. dhe e ëma J. e lindur Zh. , i lindur më datë “data e lindjes ..” në fshatin ..... Komuna e Prizrenit ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, menaxher i SH.P.K “.... ..” me seli në fshatin ..... , i martuar, baba i dy fëmijëve, me numër personal ..... , gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

**I.** Me datë 18.08.2014 në fshatin ..... Komuna e Prizrenit, shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore duke operuar ilegalisht në përpunimin – seperimin e resurseve të mineraleve, në atë mënyrë që nga inspektorët ishte hasur duke seperuar lloje të mineralit rërë dhe zhavorr në mënyrë ilegale pa u pajisur me leje për aktivitetet e veçanta – separacioni, me të cilin veprim Ministrisë së Energjisë dhe Mineraleve – Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale i shkakton dëm material në vlerë prej 5.000.00 €.

**Kësodore ka kryer veprën penale ndotja degradimi dhe shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KPK.**

**II.** Me datë 17.10.2013 në fshatin ..... Komuna e Prizrenit, shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore duke operuar ilegalisht në përpunimin – seperimin e resurseve të mineraleve, në atë mënyrë që ishte hasur nga inspektorët duke seperuar lloje të mineralit rërë dhe zhavorr në mënyrë ilegale pa u pajisur me leje për aktivitetet e veçanta – separacioni, me të cilin veprim Ministrisë së Energjisë dhe Mineraleve – Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale i shkakton dëm material në vlerë prej 5.000.00 €.

**Kësodore ka kryer veprën penale ndotja degradimi dhe shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KPK.**

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 347 par.1 të KPK i shqipton dënimin dhe atë:

## **DËNIM ME KUSHT**

Për veprën penale nën **1.** të dispozitivit i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, për veprën penale nën **2.** të dispozitivit i shqipton dënimin me burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve.

Në kuptim të nenit 80 par.1 e nenit 51 të KPK.

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

I dëmtuari Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në Prizren, nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I akuzuari obligohet të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 30 € në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë me numër PP/II.nr.58/2014 të datës 18.03.2015, kundër të akuzuarit H. E. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit, për shkak të veprave penale ndotja degradimi dhe shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KPK

Në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, gjykata shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari deklaroi se nuk e kundërshton asnjë provë në të cilën mbështetet aktakuza andaj edhe në mënyrë vullnetare ka pranuar fajësinë për veprat penale me të cilat ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 18.08.2014, në fshatin Landovicë Komuna e Prizrenit, i akuzuari H. E. si pronar i SH.P.K “.... ..” me seli në fshatin ..... Komuna e Prizrenit, shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore i cili operon në mënyrë ilegale në përpunimin e resurseve të mineraleve. Po me këtë datë zyrtarët e autorizuar – inspektorët e këtij dikasteri gjatë kontrollit kanë hasur duke seperuar lloje të mineralit rërë dhe zhavor në mënyrë ilegale pa u pajisur me leje për aktivitet të veçantë, me të cilin veprim Ministrisë së Energjisë dhe Mineraleve – Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale i shkaktonte dëm material në vlerë prej 5.000.00 €. Po kështu i akuzuari ka vepruar edhe më parë ashtu që me datë 17.10.2013 në vend të njëjtë – në fshatin ..... Komuna e Prizrenit, në mënyrë ilegale – pa leje përkatëse për kryerjen e këtyre punëve në terren e shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore duke seperuar minerale dhe atë rërë dhe zhavorr në mënyrë ilegale, pa u pajisur me leje për aktivitete të veçanta – separacioni, me të cilin veprim Ministrisë së Energjisë dhe Mineraleve – Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale i shkaktonte dëm material në vlerë prej 5.000.00 €.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit për veprimet e tij të përshkruar si në përshkrimin faktik të aktakuzës, me ç'rast edhe gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka ndonjë provë të papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht, sepse mbështet në fakte që përmban aktakuza nga se i akuzuari prej fillimit ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat të akuzuarit i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës i cili asnjëherë nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpalli fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunimi me organet e drejtësisë, sjellja korrekte e akuzuarit gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi i tij për kryerjen e veprave penale, është i gjendjes së dobët ekonomike dhe premtimin para gjykatës se në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e këtilla kundërligjore, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprave penale për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.543/2015 të datës 07.12.2015**

**Procesmbajtësja**  
**Myrvete Përdibuka**

**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.